



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:253550

Datë: 12.10.2023

Numri i dokumentit: 05065921

C.nr.967/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me gjyqtarin Përparim Zeka duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.K.S. me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson G. P., zyrtar ligjor pranë Kompanisë K. D. C. A. SHPK, kundër të paditurit F. T. nga Fshati S. Komuna Vushtrri, të cilin me autorizim e përfaqëson K. S. avokat në Vushtrri, me objekt të kontestit rimbursim i dëmit material, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik të mbajtur, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse me datë 12.10.2023, dha këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses B.K.S., me seli në Prishtinë, përmes të cilës ka kërkuar që të “detyrohet i padituri F. T. që paditëses të ia rimbursojë shumën prej 1730.00 euro në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 12.01.2013 në Obiliq dhe atë me kamatë ligjore, duke e llogaritur nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet procedurale”.

II. DETYROHET paditësja BKS me seli në Prishtinë që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, të paditurit F.T. nga Fshati S., Komuna Vushtrri, të ia paguajë shumën prej 239.00.-€ (dyqind e tridhjetë e nëntë euro) të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja B.K.S.), me seli në Prishtinë, në këtë gjykatë me datë 12.04.2017, ka parashtruar padi kundër të paditurit F. T. nga Fshati S., Komuna Vushtri për rimbursimin e dëmit material, duke theksuar se i padituri me datë 12.01.2013 rreth orës 07:15/h në Obiliq, ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin WV KOMBI 253, me targa të regjistrimit ... ku deri te aksidenti ka ardhur kur automjeti “A” të cilin e drejtonte i padituri nga pakujdesia ka shkaktuar dëme të dëmtuarit Familja T. Automjeti- kombi i cili ishte shkaktar i aksidentit në momentin e shkaktimit të tij ka qenë pa mbulesë siguroese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit. Bazuar në Ligjin nr.04/L-018 për Sigurim të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, paditësja i ka kompensuar dëmin material të dëmtuarit F. T. Andaj gjykatës i ka propozuar që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditëses dhe ta detyroj të paditurin në rimbursimin e dëmit në emër të dëmit të shkaktuar nga aksidenti i trafikut në shumën prej 239.00 €. E ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

I autorizuari i paditëses ka prezantuar në seancën kryesore, dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paraqitur në këtë gjykatë për aksidentin e datës 12.01.2013, e parashtruar kundër të paditurit F. T., shkaktar i aksidentit të trafikur. Tutje ka theksuar se BKS të dëmtuarit ia ka kompensuar dëmin e shkaktuar sipas Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, andaj i propozon gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesa e saj.

I autorizuari i të paditurit në fjalën e dhënë në seancën për shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe deklarimeve nga seancat e kaluara, duke e kundërshtuar në tërësi padinë e palës paditëse si të pa bazuar dhe duke theksuar faktin se padia është parashtruar pas kalimit të afatit të paraparë ligjor me nenin 362 par. 3 të LMD-së. që do të thotë se kërkesa e paditësit është parashkruar. Tutje ka theksuar se pala paditëse nuk ka arritur që të argumentoj bazën e padisë, madje as përgjegjësinë e të paditurit, në këtë rast për rimbursimin e dëmit, ngase

nuk ekziston asnjë vendim i formës së prerë, në të cilën do të krijohet baza juridike që të obligojë të paditurin, shtuar edhe faktin se padia e paraqitur konsideron se është e parashkruar. Andaj, bazuar në të gjitha këto, i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë kërkesëpadinë se si të pa bazuar dhe të nxjerrë një vendim merititor lidhur me këtë çështje. I ka kërkuar shpenzimet procedurale dhe atë për seancën e mbajtur shumën nga 135.00 euro, për përpilimin e përgjigjes në padi shumën prej 104.00 euro dhe në shumën e përgjithshme prej 239.00 euro.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Raporti Policor i aksidentit i datës 12.01.2013, Konfirmimi i polisës siguroese, Ujdia jashtëgjyqësore e datës 04.07.2013, Urdhër transferi bankar i datës 19.07.2013, Dosja e dëmit nr.165/13 me të gjitha shkresat e bashkëngjitura të saj.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje: LPK), arriti në përfundim se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga Raporti Policor i aksidentit i datës 12.01.2013, gjykata ka vërtetuar faktin se i dëmtuari në aksident trafiku, F. T. ka parashtruar kërkesë pranë të paditëses BKS për rimbursimin e dëmit material.

Gjykata nga Vendimi i lëshuar nga Departamenti i dëmeve i BKS me numër FK-165/13 i datës 21.01.2013, ka vërtetuar faktin se është miratuar kërkesa e të dëmtuarit në shumën prej 1.730.00 euro për kompensimin e dëmit në automjet të pësuar në aksident trafiku me datë 12.01.2013.

Nga Ujdia Jashtëgjyqësore e lidhur mes BKS dhe Familja T. me përfaqësues av.B. A. nga Prishtina, me datë 04.07.2013 me numër të lëndës FK 165/13, gjykata ka vërtetuar se është arritur pëlqimi që të dëmtuarës të lartpërmendur të i bëhet pagesa në emër të dëmit të pësuar në lartësi prej 1.730.00 euro.

Nga Urdhër transferi bankar i datës 19.07.2013, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja nga xhirollogaria e saj ka bërë transferin e mjeteve për dëmet, tek përfituesi av. B. A. për F. T. në vlerë prej 1.730.00 euro, sipas referencës BKS-FK 165/13.

Gjykata ka vendosur që ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit për faktin se sipas vlerësimit të saj në këtë çështje juridike kontestimore kërkesa e paditësit BKS është parashkruar, pasi që aksidentit ka ndodhur me datë 12.01.2013, kurse me datë 04.07.2013 me ujdinë jashtëgjyqësore paditësja e ka përmbushur obligimin ndaj të dëmtuarit në aksidentin e ndodhur me datë 12.01.2013, kurse paditësja ka dorëzuar në gjykatë padinë më datës 14.04.2017, rrjedhimisht afati i parashkrimit ka filuar të rrjedh nga data 01.01.2014, kjo bazuar në nenin 362 par.1 të LMD-së ku është përcatuar se: “Kërkesat e kontraktuesve të sigurimit, respektivisht të personit të tretë nga kontrata e sigurimit të jetës, parashkruhen për pesë (5) vjet, kurse nga kontratat e tjera për sigurimin për tre (3) vjet, duke llogaritur që nga dita e parë pas kalimit të vitit kalendarik në të cilin është krijuar kërkesa”. Bazuar në këtë gjendje faktike gjykata ka vendosur që ta refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për arsye se kemi të bëjmë me parashkrim ku si rrjedhojë e kësaj kanë kaluar 3 vite e 4 muaj.

Nga kjo rrjedh se, paditësja lidhur me aksidentin dhe shkaktarin e saj fillimisht është njoftuar me datë 14.04.2017 (data e paraqitjes së kërkesës për kompensim dëmi), ku në dosjen e saj si shkaktar të aksidentit kanë shënuar emrin e të paditurit F. T. Më pas, pasi ka bërë vlerësimin e rastit, paditësja ka miratuar kërkesën e lartcekur me Vendimin e datës 25.06.2013, ndërsa me datë 19.07.2013 nga paditësja është realizuar transferi për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial në emër të të dëmtuarit. Në drejtim të vlerësimit të parashkrimit të kërkesës së paditëses, gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret meqë kompensimi i dëmit është realizuar me datë 19.07.2013, ndërsa padia është

parashtruar me datë 14.04.2017, kanë kaluar tre vite e katër muaj nga lindja e të drejtës për rimbursim dëmi, ashtu që bazuar në dispozitat e lartcekura, e në ndërlidhje edhe me nenin 342 par.1 të LMD-së, sipas të cilit “Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër.”, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi kur e refuzoi në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Gjykata vendosi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç’rast të paditurit iu pranuan shpenzimet në vlerë prej 239.00 euro, lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në padi shuma prej 104.00 euro taksën gjyqësore shuma prej 30 euro dhe për përfaqësim në seanca shuma në vlerë prej 135.00 euro lartësia e të cilave u përcaktua në bazë të Rregullores për Tarifat e Avokatëve të Kosovës e datës 18.03.2017.

Nga të lartcekurat, dhe konform nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE Prishtinë

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.967/17 me datë 12.10.2023

Gj y q t a r i,
Përparim Zeka

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.